



**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
DREJTORIA E TARIFAVE DHE ÇMIMEVE**

**RELACION
MBI MIRATIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE
PËR PERIUDHËN 2022-2024**

Bordit të ERE-s

Këtu

Të Nderuar Anëtarë të Bordit,

Në zbatim të nenit 19, gërma c), pika i) të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti përgjegjës për miratimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike.

ERE me vendimin e Bordit Nr. 180, datë 08.11.2017, ka miratuar “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, e cila ka për qëllim përcaktimin e parimeve, kushteve dhe procedurave të tarifave të përdorimit të rrjetit të transmetimit mbi bazën e parimeve të llogaritjes së këtyre tarifave duke vlerësuar të dhënat e domosdoshme për një tarifë të drejtë.

Në zbatim të pikës 1, të nenit 21 të “Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s, i licencuari që kërkon përcaktimin e tarifave dhe çmimeve të shërbimeve të energjisë elektrike dhe të gazit natyror për vitin pasardhës, jo më vonë se data 1 Shtator të vitit aktual, duhet të paraqesë në ERE një kërkesë me shkrim të shoqëruar me të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e kërkuar sipas kësaj rregullore dhe metodologjive përkatëse.

Aplikimi i paraqitur duhet të shoqërohet me dokumentacionin përkatës sipas parashikimeve të nenit 22, të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin Nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s dhe “Sistemit të njehsuar dhe të standartizuar të llogarive për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike për aktivitetet e transmetimit, shpërndarjes dhe furnizuesit të shërbimit universal të energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s Nr. 244, datë 26.11.2018.

Shoqëria OST sh.a me shkresën nr. 5215 Prot., datë 31.08.2021 (protokolluar me tonën me nr. 914 Prot., datë 02.09.2021), ka depozituar në ERE kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 si dhe për periudhën 2022-2024, sipas materialit që OST sh.a i ka bashkangjitur kësaj shkrese, i cili është në përputhje me afatet e parashikuara në pikën 1, të nenit 21, të Rregullores për “Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin nr. 96, datë 17.06.2016 të Bordit të ERE-s

Në vijim të aplikimit të mësipërm, OST sh.a ka përcjellë shkresën me Nr. 5215/1, datë 05.10.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 914/1, datë 06.10.2021) ku ka argumentuar se për shkak të trendit të rritjes së çmimit të energjisë në tregun rajonal për periudhën e mbetur të vitit 2021 (vit testimi) dhe periudhat në vazhdim, parashikoi ndryshimin e kostove të blerjes

së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit, duke përditësuar dhe tarifën e parashikuara për vitin 2022 dhe periudhën 2022-2024.

Në zbatim të VKM-së Nr. 584, datë 08.10.2021 “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike“, ERE me shkresën Nr. 914/2 Prot. datë 11.10.2021, i kërkoi OST sh.a përditësimin e të dhënave sipas përcaktimeve të VKM-së si dhe plotësimin e disa prej kërkesave thelbësore të metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit.

Kërkesës së mësipërme OST sh.a i është përgjigjur me shkresën Nr. 5215/3 Prot. datë 04.11.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 914/3, datë 05.11.2021), me anë të së cilës ka përcjellë të dhënat e korrigjuara.

Po kështu, në kuadër të dispozitave të përcaktuara në VKM-në e sipërcituar, me shkresën Nr. 1055 Prot. datë 04.11.2021, ERE i ka kërkuar shoqërisë OST sh.a dërgimin e planit të përditësuar të investimeve për 2021 si dhe planit dhjetëvjeçar 2015 – 2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit. Në vijim OST sh.a është përgjigjur me shkresën Nr. 6536/1 Prot. datë 16.11.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 1055/1, datë 17.11.2021).

Pas shqyrtimit të kërkesës së OST sh.a, në mbështetje të legjislacionit sipërcituar, Bordi i ERE-s me Vendimin Nr. 234, datë 19.11.2021, vendosi: **“Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2022 dhe për periudhën 2022 – 2024”**.

Mbas vendimmarrjes së fillimit të procedurës, përgjatë procesit të shqyrtimit të këtij aplikimi janë kryer veprimet e mëposhtme procedurale:

- Aplikimi si dhe të gjitha korrespondencat që kanë ardhur nga shoqëria OST sh.a janë publikuar në faqen elektronike të ERE-s www.ere.gov.al sipas afateve të përcaktuara në *Rregulloren për Organizimin e brendshëm, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*”.
- ERE me shkresën Nr. 914/4, datë 26.11.2021, në kuadër të transparencës dhe një vendimarrje sa më të drejtë, i ka kërkuar shoqërisë OST sh.a dhënien e argumentave, informacioneve shtesë si dhe dokumentacionit përkatës në lidhje me çështjet e evidentuara nga shqyrtimi materialeve të përcjella në kuadër të aplikimit për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike për periudhën 2022-2024.
- Në zbatim të Urdhrit të Kryetarit të ERE-s nr. 88, datë 26.11.2021, në ambientet e ERE më datë 03.12.2021 u zhvillua seanca teknike ndërmjet përfaqësuesve të ERE-s dhe të shoqërisë OST sh.a. ku u diskutua në lidhje me informacionin, argumentat dhe dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria. Në përfundim, shoqëria OST sh.a. ju la detyrë përgjigjia me shkresë mbi pyetjet dhe paqartësitë e evidentuara gjatë seancës.
- Në përgjigje të shkresës Nr. 914/4, datë 26.11.2021, OST sh.a depozitoi shkresën Nr. 6954 Prot, datë 02.12.2021 (Protokolluar në ERE me Nr.914/6, datë 06.12.2021), përmes së cilës dha informacionin dhe argumentat e saj për sa kërkuar nga ERE në shkresën sipërcituar.
- Në zbatim të VKM-së Nr. 584, datë 08.10.2021 “Për Shpalljen e Gjendjes së Emergjencës në Furnizimin me Energji Elektrike”, është përcaktuar se shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe OSHEE Group sh.a, duhet të pezullojnë planet e investimeve, përveç investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarisë. Për sa më sipër ERE me shkresën Nr. 1121 Prot. datë 03.12.2021, i është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, në rolin e autoritetit përgjegjës, lidhur me udhëzimet mbi përcaktimin e investimeve të domosdoshme për ushtrimin e veprimtarive të shoqërive OSSH sh.a. dhe OST sh.a..
- Më tej, me shkresën Nr. 1136 Prot. datë 10.12.2021, ERE i është drejtuar të gjitha palëve të interesit për dhënien me shkrim të opinionëve dhe komenteve mbi Vendimin e Bordit të

ERE-s Nr. 234, datë 19.11.2021. Gjithashtu, duke vlerësuar rëndësinë e gjithëpërfshirjes së këtyre grupeve në këtë vendimarrje, iu komunikua zhvillimi i seancës dëgjimore publike, e cila në zbatim të Urdhërit të Kryetarit të ERE-s Nr. 53, datë 11.03.2020, i ndryshuar, “Për ushtrimin e veprimtarisë të Entit Rregullator të Energjisë dhe zhvillimin e mbledhjeve apo seancave dëgjimore”, në respektimin e masave anti – COVID, u parashikua të zhvillohej me datë 29.12.2021 nëpërmjet platformave elektronike të komunikimit.

- Pas shqyrtimit të të gjithë korrespondencës të sipërcituara, si dhe duke marrë në konsideratë pyetjet e lindura gjatë seancës dëgjimore teknike, ERE ju drejtua sërish shoqërisë OST sh.a me shkresën Nr. 914/7, datë 16.12.2021, për dhënie e informacioneve, argumentave si dhe dokumentacioneve mbështetës mbi paqartësitë e evidentuara, duke i konsideruar si të nevojshme për procesin e vendimarrjes.
- OST sha me shkresën Nr. 6901/3 Prot. datë 23.12.2021 (Protokolluar me tonën Nr. 914/8, datë 28.12.2021) depozitoi në ERE sqarimet dhe argumentat e saj për sa kërkuar nga ERE.
- ERE më datë 29.12.2021 organizoi seancën dëgjimore publike, ku palët e interesit parashtruan pyetjet e tyre në lidhje me aplikimin e shoqërisë OST sha për përcaktimin e tarifës së transmetimit për periudhën 2022-2024. Në përfundim të seancës, shoqërisë ju la detyrë përgjigjia me shkrim e pyetjeve ose paqartësive të çdo grupi interesi. Në vijim të sa më sipër, shoqëria ende nuk është përgjigjur ndaj pyetjeve të adresuara në këtë seancë.
- Me anë të postës elektronike ardhur në adresën erealb@ere.gov.al, datë 29.12.2022, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë në kuadër të aplikimeve të OST sh.a dhe OSSH sh.a ndër të tjera ka kërkuar ndaj ERE mos ndryshimin e tarifave për vitin 2022.
- ERE me shkresën nr. 216, datë 03.02.2022, i kërkoi OST sh.a dërgimin e:
 - Pasqyrave Financiare të plota të vitit 2021 si dhe paraqitjen në formë analitike të të ardhurave dhe shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2021;
 - listën e investimeve sipas burimit të financimit të shoqëruar me vlerën përkatëse të secilit projekt, të cilat kanë hyrë në operim gjatë vitit 2021.
 - Analizën e plotë për parashikimin e vlerës së kapacitetit të shërbimeve ndihmëse për periudhën 2022-2024, vlerësimin e saj mbështetur në vlera dhe skenarë konkretë lidhur me ndikimin në parashikimin e vlerës së kapacitetit që priten të lidhen në sistemin elektroenergetik.
 - Shoqëria OST sh.a. me anë të shkresës nr.851/1, datë 14.02.2022 sqaroi se pasqyrat financiare të plota të vitit 2021 janë ende në proces hartimi ndërkohë përcolli pasqyrën e pozicionit financiar dhe pasqyrën e të ardhurve dhe shpenzimeve, një raport mbi aktivitetin e OST sh.a.për vitin 2021 si dhe një analizë sa i takon parashikimeve të saj për shërbimet ndihmëse për periudhën 2022-2024
- OST sh.a. në zbatim të Vendimit të ERE Nr. 255, datë 21.12.2021 mbi “Propozimin e shoqërisë OST sh.a., në pikën 6 të të cilit citohet se: “Përgjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM Nr. 584, datë 22.10.2021, OST sh.a. të raportojë çdo javë në ERE mbi ecurinë e Tregut të balancimit të energjisë elektrike, duke filluar nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare”, OST sh.a. ka detyrimin të paraqesë në ERE raportim javor lidhur me zbatimin e Rregullave të TShB. Për arsyet e sipërcituara, OST sh.a. ka dërguar në ERE me emailin e dates 07.02.2022 Raportim javor për periudhën 01 deri 31 Janar 2022 mbi ecurinë e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike.
- Mbas shqyrtimit të këtij raporti, ERE me anë të emaili të datës 22.02.2022 kërkoi ndaj OST sh.a. përllogaritjet në Excel për kapacitetet rezervë të përdorura në çdo orë për periudhë, shoqëruar çmimet respektive si dhe kostot e ndara për secilën Rezervë: FCR, aFRR dhe mFRR të përdorura për muajin Janar 2022 si dhe vlerësimet të aplikimit të tarifave, bëhet e nevojshme të dërgoni shpenzimet për shërbimet ndihmëse dhe të balancimit sipas secilës rezerve (FCR, aFRR dhe mFRR), të cilat janë realizuar duke evidentuar dhe te ardhurat e realizuara nga shitja e shërbimeve ndihmëse ndaj KOST për çdo muaj të vitit 2021.

- OST sh.a. me e-mailin e datës 24.02.2022 dërgoi në ERE tabelat në formatin Excel lidhur me të ardhurat dhe shpenzimet nga kapaciteti rezervë të vitit 2021 dhe për muajin janar 2022.
- Mbas shqyrtimit të materialeve të dërguara, ERE me anë të e-mailit të datës 28.02.2022 kërkoi prej OST sh.a, të dhëna mbi kapacitetet rezervë të përdorura në çdo orë për periudhë, shoqëruar me çmimet respektive si dhe kostot e ndara për secilën Rezervë: FCR, aFRR dhe mFRR, me qëllim vlerësimin e mënyrës së përlogaritjes së shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara nga shërbimet ndihmëse për vitin 2021. Deri më tani shoqëria OST nuk ka depozituar ende një përgjigje në lidhje me sa kërkuar më sipër.

Procesi i shqyrtimit të aplikimit ka kaluar nëpërmjet rishikimit të vazhdueshëm të kërkesës për të ardhura nga OST sh.a., fillimisht me kërkesën drejtuar ERE me anë të shkresës nr. 5215 Prot., datë 31.08.2021 dhe më tej përditësimin tij me anë të shkresave nr.5215/1 prot., datë 5.10.2021, Nr. 5215/3 Prot. datë 04.11.2021 dhe Nr. 6901/3 Prot. datë 23.12.2021.

Këto ndryshime janë justifikuar me situatën e pazakontë të rritjes së çmimit të energjisë elektrike të blerë në tregun e lirë me qëllim mbulimin e humbjeve.

Rillogaritja e të ardhurave të kërkuara në korrespondencat e përcjella gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit ka sjellë ndryshimin 4 (katër) herë të tarifës mesatare të transmetimit të propozuar për periudhën 2022 – 2024.

Sa më sipër, shoqëria ka shfaqur dukshëm pasiguri në parashikimin e kostove operative si dhe kapitale, duke e reflektuar dhe në paqëndrueshmërinë e vlerës së parashikura të të ardhurave të kërkuara për periudhën e kërkuar.

Referuar përditësimeve të fundit, të përcjella nga OST sh.a. me shkresën Nr. 6301/3 Prot, datë 23.12.2021 (Protokolluar në ERE me Nr. 914/8, datë 28.12.2021), të ardhurat e kërkuara të realizuara për vitet 2020 dhe parashikimi për mbylljen e vitit 2021 dhe për periudhën 2022-2024, paraqiten si më poshtë:

Tabela 1: Të ardhurat e realizuara 2020- 2021 sipas OST sh.a

Përshkrimi	Uniti	2020		2021		Te ardhurat e munguara		Te ardhurat e munguara 2020-2021
		Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metodologjisë	Tarifa Aktuale	Tarifa sipas Metodologjisë	2020	2021	
$C = C_{\text{kapital}} + C_{\text{operuese}} - \text{Te ardhurat nga aktivitetet tjera}$		5,270	5,339	5,730	6,463	69	733	801
I. C kapital= R+D		3,954	4,023	3,254	3,987			
1 Këmbimi mbi kapitalin ($R = B * wacc$)	Million ALL	1,558	1,627	849	1,582			
a. B (Baza e rregulluar e aseteve)	***	38,003	38,003	37,004	37,004			
b. WACC = $[ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)$	%	4.10%	4.28%	2.30%	4.28%			
ES - Objektiv për raportin e kapitalit të vet në RAB	***	6126%	6126%	63.44%	63.44%			
T - Norma e takses së korporates	***	15.00%	15.00%	15.00%	15.00%			
ARoE - Norma e keqare të kthimit mbi kapitalin e vet pas takse	***	3.75%	4.00%	13.5%	4.00%			
DS - Objektiv për raportin e borxhit në RAB	***	38.74%	38.74%	36.56%	36.56%			
CoD - Kosto e borxhit	***	3.6%	3.6%	3.53%	3.53%			
2 Amortizimi i vitit (D)	Million ALL	2,396	2,396	2,405	2,405			
II. C operuese		3,064	3,064	4,757	4,757			
1 Personeli	***	1368	1368	1263	1263			
2 Shërbime administrative të tjera	***	642	642	546	546			
3 Materiale të para	***	79	79	103	103			
4 Blerja e shërbimeve ndihmëse	***	152	152	498	498			
5 Blerja e humbjeve	***	843	843	2,086	2,086			
6 Pagesë ITC (Inter-ISO Compensation mechanism)	***	80	80	261	261			
III. Te ardhurat nga aktivitetet tjera		(1,748)	(1,748)	(2,282)	(2,282)			
E - Energji e transmetuar (OSHIE -ve tjere)	GWh	7,027	7,027	7,640	7,640	7,027	7,640	14,667
Tarifa mesatare e transmetimit	Lek/kWh	0.75	0.76	0.75	0.85	0.01	0.10	0.05

Tabela 2: Të ardhurat e kërkuara për vitin 2022 dhe periudhën 2022 – 2024 sipas OST sh.a

Metodologjia e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë		2022	2023	2024
Përshkrimi				
	Njesia			
C = C kapital + C operuese - Te ardhurat nga aktivitetet tjera		11,360	10,824	10,737
I	C kapital= R+D	4,287	4,576	4,794
1	Kthimi mbi kapitalin (R = D*wacc)	1,601	1,746	1,870
Milion Leke				
a. B (Baza e rregulluar e aseteve)		36,937	41,276	43,867
b. WACC = [ES * ARoE / (1-T)] + (DS * CoD)		4.33%	4.23%	4.26%
ES - Objektiv për raportin e kapitalit të vet në RAB		63.8%	61.09%	61.56%
T - Norma e takses së korporates		15.00%	15.00%	15.00%
ARoE - Norma e lejuar e kthimit mbi kapitalin e vet pas takse		4.00%	4.00%	4.00%
DS - Objektiv për raportin e borzhit në RAB		36.82%	38.9%	38.44%
CoD - Kosto e borzhit		3.70%	3.48%	3.55%
2	Amortizimi i vitit (D)	2,686	2,830	2,924
Milion Leke				
II	C operuese	8,458	7,681	7,428
1	Personeli	1,373	1,399	1,425
2	Shërbime administrative e të tjera	733	711	715.00
3	Menaxhimi i kongjestionit me rrispecim	521	558	595
4	Materiale të para	132	134	136
5	Blerja e shërbimeve ndihmëse	1,708	1,924	2,050
6	Blerja e humbjeve	3,741	2,705	2,257
7	Pagesë FIT (inter TSO Compensation mechanism)	250	250	250
III	Te ardhurat nga aktivitetet tjera	(1,385)	(1,433)	(1,485)
E - Energji e transmetuar (OSHEE *te tjere)		GWh	7,720	7,795
Tarifa mesatare e transmetimit		Le/kWh	1.47	1.39
			1.39	1.36

Tarifa mesatare 3- vjeçare e transmetimit sipas përlllogaritjeve të përditësuara nga OST sh.a kërkohe në vlerën **1.41 lekë/kWh.**

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë deri më tani nga OST sh.a. në kuadër të këtij procesi, sikurse theksuar edhe më lartë, treguesit dhe komponentët e të ardhurave të kërkuara, të parashikuar për periudhën rregullatore të propozuar 2022-2024 por dhe parashikimet e vitit bazë 2021, janë rillogaritur duke shkaktuar ndryshime të theksuara dhe në tarifën mesatare të propozuar. Nga analiza e të dhënave të përcjella me korrespondencat e deritanishme, vlerësojmë se OST sh.a. ka patur ndryshime në parashikimet e saj për kostot e blerjes së humbjeve në tregun e lirë, komponent i cili ka afektuar një rritje të theksuar të kostove të shoqërisë për periudhën tashmë të mbyllur 2021 si dhe të parashikimeve të saj mbi periudhën rregullatore 2022-2024. Gjithashtu, referuar të dhënave si dhe diskutimeve të kryera gjatë këtij procesi, komponent tjetër i rëndësishëm në vlerësimin e të ardhurave të kërkuara për OST sh.a. ka qënë shpenzimet për shërbimet ndihmëse. Mbështetur në deklaratat e shoqërisë, luhatja e ndjeshme e realizimit të këtij shpenzimi si dhe të parashikimit të tij për periudhën e ardhshme, kanë ardhur si efekt i hyrjes në fuqi të rregullave të tregut të balancimit nga data 01.04.2021.

Pas dërgimit të të dhënave faktike të vitit 2021 nga ana e OST sh.a., krahasuar me parashikimet e dërguara nëpërmjet aplikimit të përditësuar të tarifave si dhe me të dhënat e dërguara si parashikim i pritshëm për vitin 2021, ERE konstatoi ndryshime të theksuara të kostove operative si dhe kapitale. Pas analizimit së këtyre të dhënave, mbështetur në përcaktimet e “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, janë kryer vlersësimet mbi secilin komponent të të ardhurave të kërkuara duke përlllogaritur kostot të cilat priten të realizohen nga OST sh.a në periudhën pasardhëse. Këto përlllogaritje janë bazuar dhe në kostot faktike të viteve 2019-2020 si dhe vitit të testimit 2021, tashmë i mbyllur.

Gjatë këtij procesi janë shqyrtuar të gjitha korrespondencat, të dhënat dhe dokumentat e përcjella për të përlllogaritur një tarifë sa më të drejtë, të arsyeshme dhe kosto reflektuese për ushtrimin e aktivitetit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit. Në vlerësimet tona janë konsideruar kostot operative dhe kapitale të arsyeshme, të matshme dhe reale në zbatim të parimeve të vendosjes së tarifave mbështetur në Ligjin 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar, si dhe Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike” miratuar nga Bordi i ERE-s me Vendimin Nr.180, datë 08.11.2017.

Në kuadër të sa më sipër, ERE ka kërkuar vazhdimisht prej OST sh.a. paraqitjen e një aplikimi për tarifën e transmetimit për një periudhë rregullore 3 -vjeçare duke synuar stabilitetin në tarifën e përdorimit të rrjetit, parim i cili është i parashikuar në Metodologjinë e përcaktimit të tarifave të transmetimit të energjisë elektrike.

Nga shqyrtimi i aplikimit, korrespondencave të deritanishme si dhe materialeve plotësuese, të dërguara në ERE në kuadër të zhvillimit të këtij procesi, paraqesim në vijim konstatimet dhe vlerësimet tona për sa përcjellë deri më tani nga OST sh.a duke evidentuar dhe diferencat në vlera për çdo element të të ardhurave të kërkuara:

Shpenzimet operative (OPEX)

Në tabelën në vijim paraqesim krahasimet dhe diferencat midis aplikimit të përditësuar si dhe konsiderimeve/vlerësimeve tona për nivelin e çdo grup shpenzimi të shoqërisë për vitin 2021 si dhe parashikimet për periudhën 2022-2024:

Zeri	APLIKIMI 2022-2024 I OST SH.A.					Mesatare 3 vjeçare parashikim OST	PERLLOGARITJET E ERE 2022-2024						Mesatare 3 vjeçare parashikim ERE
	Realizuar nga OST 2020	Parashikimi OST 2021	Parashikim 2022	Parashikim 2023	Parashikim 2024		Pranimet e ERE mbi Realizimin e 2019	Pranimet e ERE mbi Realizimi e 2020	Pranimet e ERE mbi Realizimi e 2021	Parashikim 2022	Parashikim 2023	Parashikim 2024	
Mirembajtje							195	129	120	124	127	131	127
Shpenzime materiale	79	103	132	134	136	134	113	79	88	91	93	96	93
Personeli	1,168	1,263	1,373	1,399	1,425	1,399	1,170	1,153	1,188	1,223	1,260	1,298	1,260
Blerje energji për humbjet	843	2,086	3,741	2,705	2,257	2,901	991	843	2,089	3,741	2,705	2,257	2,901
Sherbime ndihmese	152	498	1,708	1,924	2,050	1,894	148	152	372	409	430	451	430
menaxhim kongestion me ridispecerim			521	558	595	558							-
CBT	180	261	250	250	250	250	173	180	234	250	250	250	250
Furnitura dhe Shërbime	642	546	733	711	715	720	334	366	365	376	387	399	387
Pagese për organizmat rajonale europian te tjera						-	54		93	93	93	93	93
						-	3		13	13	13	13	13
Totali i OPEX	3,064	4,757	8,458	7,681	7,428	7,856	3,180	2,902	4,561	6,320	5,358	4,988	5,555

Shpenzimet e personelit

Shpenzimet e personelit janë propozuar në rritje nga OST për periudhën rregullore 2022-2024, sipas vlerës së paraqitur në tabelën e mësipërme. Nga korrespondencat me shoqërinë gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit të tarifës mesatare të transmetimit, OST parashikon rritje të zërave të shpenzimeve si më poshtë:

- ‘‘shtesa turnesh dhe orë jashtë orarit’’,
- ‘‘udhëtime dhe dieta’’, /
- ‘‘shpenzime të tjera personeli’’,

Bazuar në ‘‘Metodologjinë e llogaritjes së tarifës së transmetimit’’, në këtë zë duhet të përfshihen pagat, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe kostot (të ndryshme nga taksat) të lidhura me programet në përfitim të të punësuarve. Lidhur me sa më sipër vlersojmë se zëri ‘‘udhëtime dhe dieta’’ nuk është një zë që duhet të përfshihet në parashikimin e këtij shpenzimi. Më tej, theksojmë se në periudhat paraardhëse këto zëra shpenzimesh janë realizuar në vlera më të ulëta dhe nuk e kanë penguar ushtrimin e aktivitetit të shoqërisë. Për sa përcjellë nga shoqëria, konstatohet se vlera e kërkuar e këtij shpenzimi vjen me një rritje prej 8% për vitin 2021 kundrejt realizimit të vitit 2020, një rritje prej 8.71% të këtij zëri për parashikimin e vitit 2022 mbi vlerën e kërkuar për 2021, e më tej për vitet 2023-2024 rritja e këtij shpenzimi parashikohet në nivelin 1.86% ndaj parashikimit për vitin paraardhës.

Në zbatim të pikës 2, të nenit 7 “Metodologjisë së llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të energjisë elektrike”, rregullimet në vitin e testimit duhet të konsiderojnë indeksimin bazuar në normën e inflacionit. Sa më sipër, shpenzimet e personelit për vitin bazë duhet të njihen me një rritje sipas normës së inflacionit nga vlera e realizuar e tij në vitin e testimit 2021. Sa i takon vitit 2021 është konsideruar vlera e vitit 2020, e cila është indeksuar me normën e synuar të inflacionit. Po kështu, për çdo vit të periudhës rregullatore, vlerësojmë përlllogaritjen e shpenzimeve të personelit duke u bazuar në parashikimin e vitit paraardhës të rregulluar me normën e inflacionit të pritur, sikurse paraqitet në tabelën e mësipërme me emertësën “Përlllogaritje ERE për periudhën 2022-2024”.

Shpenzime materiale të para

Ne aplikim, shoqëria parashikon për këtë zë shpenzimesh një kosto mesatare vjetore prej 134 milion lekë për periudhën 2022-2024 dhe për vitin 2021 një vlerë prej 103 milion lekë, ose shprehur ndryshe 30% më të lartë krahasuar me realizimin e vitit 2020. Referuar të dhënave operative të vitit 2021 të përcjella, shoqëria deklaron se për vitin 2021 zëri Shpenzime per materiale të para është realizuar në vlerën 88 milion lekë.

Për analogji me vlerësimet lidhur me shpenzimet e personelit, konsiderojmë se për përlllogaritjen e vlerës së lejuar për vitin 2022 të shpenzimeve materiale duhet të merret realizimi i vitit 2021 prej 88 milion lekë, duke e indeksuar me normën e synuar të inflacionit prej 3%, për çdo vit të periudhës rregullatore 2022-2024,. Vlerat rezultuese janë pasqyruar në tabelën e mësipërme me emertësën “Përlllogaritje ERE për periudhën 2022-2024”

Menaxhimi i konxhestionit me ridispeçerim

Nga të dhënat e aplikimit, parashikimi i shoqërisë për shpenzimin e Menaxhimit të Konxhestionit me Ridispeçerim për periudhën 2022-2024, llogaritet me një kosto mesatare vjetore 558 milion lekë. Kërkesën e saj shoqëria e mbështet me argumentin se:

“...për të çliruar konxhestionin në rrjet, në rastet kur shfaqet, aplikohet ridispeçerimi, që nënkupton uljen e gjenerimit në një pikë të caktuar të injektimit në rrjet, dhe rritjen respektive të gjenerimit në një pikë tjetër të injektimit në rrjet, ose sipas rastit vetëm uljen apo rritjen e gjenerimit në funksion të konxhestionit të krijuar. Gjithashtu hyrja në fuqi e “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” nuk i le më hapësira OST-së të kërkojë këtë shërbim tek përdoruesit e rrjetit, në funksion të sigurisë së punës së Sistemit dhe sigurisë së furnizimit pa shlyer detyrimet financiare për shërbimin e kërkuar nga OST dhe të ofruar nga përdoruesit.”

Nga diskutimet në seancën dëgjimore teknike si dhe sqarimet dhe analizat e të dhënave në korrespondencat e sipërcituara, pavarësisht se në rregullat e tregut të balancimit është e përcaktuar se: *OST do të ketë detyrimin që të përdorë ofertat me kohë aktivizimi më të gjatë se 30 minuta*, ekskluzivisht për menaxhimin e kongestionit, është konstatuar se ky shpenzim nuk ka ndodhur ndonjëherë në periudhat e mëparshme por edhe pas hyrjes në fuqi të rregullave në fjalë. Ky konstatim është pranuar dhe nga vetë shoqëria, e cila ka deklaruar se ky shpenzim nuk ka ndodhur asnjëherë gjatë vitit 2021. Me tej, në përgjigje të kërkesave të ERE-s për të sqaruar mënyrën e përlllogaritjes, shoqëria deklaron se ka identifikuar dy zona të mundshme ku mund të aplikohet mekanizmi për të mënjanuar mbingarkesën.

Pika 2, neni 7 i “Metodologjisë së llogaritjes së Tarifave të Transmetimit të Energjisë Elektrike” përcakton se: *Fondet e planifikuara për mbulimin e kostove të ngjarjeve të pasigurta apo të pa parashikuara, nuk do të miratohen nga ERE.*

Për sa më sipër shpjeguar, sqarojmë se megjithëse shoqëria prej prillit të vitit 2021 operon me Rregullat e Reja të Tregut të Balancimit, deri më tani OST nuk ka patur asnjëherë shpenzime për Menaxhimin e Kongjestionit. Për rrjedhojë, këtë zë shpenzimi e vlerësojmë si një ngjarje të pasigurtë dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet në të ardhurat e kërkuara si një fond rezervë, i cili e afekton ndjeshëm përlllogaritjen e tarifës së transmetimit për periudhën 2022-2024.

Blerja e shërbimeve ndihmëse

Shoqëria në aplikim parashikon blerjen e shërbimeve ndihmëse për periudhën 2022-2024 me një kosto mesatare vjetore prej 1,894 milion lekë. Rritjen e këtij shpenzimi shoqëria e argumenton me kushtet e prokurimit të rezervës në bazë tregu duke patur parasysh hyrjen në fuqi të “Rregullave të Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”. Gjithashtu shoqëria deklaron se metodologjia për përlllogaritjen e koeficientit të kontributit merr në konsideratë gjenerimin dhe konsumin në vend. Në vijim, argumenton se zhvillimi i burimeve te rinovueshme dhe integrimi i tyre sjell domosdoshmërinë e rritjes së kapacitetit rezervë.

Gjatë procesit të shqyrtimit të aplikimit për tarifën e transmetimit për vitin 2022, nga muaji shtator deri në dhjetor 2021, shoqëria ka ndryshuar parashikimin e saj për vitin 2021 tre herë. Krahasuar me vlerën e parashikuar të këtij shpenzimi në Shtator 2021, parashikimi i këtij zëri i përcjellë në muajin dhjetor është reduktuar nga 846 milion lekë në 498 milion leke.

Në shkresën e fundit të depozituar në ERE-s nga shoqëria vërehet se kostot faktike të këtij zëri për vitin 2021 kanë qenë **372.1 milion leke**. Lidhur me këtë shpenzim është analizuar edhe parashikimi i shoqërisë në aplikimin e tarifave të viti 2021, në të cilin rezulton se vlera e kërkuar në atë kohë ka qenë 1,184 milion lekë, ndërkohë që vlera e realizuar është dukshëm shumë here më e ulët.

Sa më sipër sqaruar, parashikimin në rritje të këtij zëri shoqëria e argumenton përmes metodologjisë së përlllogaritjes së koeficientit të kontributit, sipas së cilit merret në konsideratë gjenerimi dhe konsumi në vend. Por gjatë vitit 2021, sasia faktike e lëvruar në rrjetin e transmetimit ka qenë 7,656 MWh, kundrejt 7,216 MWh që shoqëria ka parashikuar për t’u lëvruar. Në kushtet ku vlera faktike e sasisë së lëvruar në rrjetin e transmetimit për vitin 2021 ka qenë më e lartë se sasia e parashikuar për t’u lëvruar në rrjet për të njëjtën periudhë, kostot e realizuara të shërbimeve ndihmëse kanë qenë shumë më të ulëta se sa parashikimi i kryer nga shoqëria.

Nga analiza e të dhënave të paraqitura konstatohet se: parashikimet e shoqërisë mbi kapacitetet e lidhjes së centraleve eolike dhe fotovoltaike në rrjetin e transmetimit janë përtej periudhës rregullatore 2022-2024 (vetëm 220.4 MW parashikohet të lidhet në rrjet deri në 2023, 465.4 MW deri në 2028 dhe 915.4 MW deri në 2033).

OST sha, në kuadër të marrëveshjes me KOSTT për prokurimin e shërbimeve ndihmëse, pas kërkesës së ERE-s, dërgoi me anë të e-mailit të datës 22.02.2022, shpenzimet dhe të ardhurat e gjeneruara nga shitja e shërbimeve ndihmëse, të cilat paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Muaji	Shpenzime				Te ardhura		
	Sherbime Ndhimese (Kapacitet Rezerve)				Sherbime Ndhimese KOSTT (Kapacitet Rezerve)		
	FCR	a FRR		m FRR	FCR	a FRR	m FRR
ne [Euro]	ne [Lek]	ne [Euro]	ne [Euro]	ne [Euro]	ne [Euro]	ne [Euro]	
Janar		23,101,200.00				331,798.33	
Shkurt		20,865,600.00				86,181.04	
Mars		23,070,150.00				274,470.95	
Prill			908,409.75			534,679.81	
Maj			1,070,492.12	24,529.00		303,374.97	
Qershor			747,904.63	3,182.40		250,074.75	
Korrik			838,604.50			385,877.14	
Gusht			743,706.00			554,639.18	
Shtator			668,434.19			187,784.47	
Tetor			619,248.00	30,434.30		1,052,675.97	
Nentor			557,983.65			1,626,834.20	
Dhjetor			384,028.75			2,971,194.34	
Total	0	67,036,950.00	6,538,811.59	58145.7	0	8,559,585.15	

Në këtë tabelën rezulton se OST sh.a. ka realizuar të ardhura nga shitja e shërbimeve ndihmëse në vlerën 177 milion lekë.

Për qëllime të analizës së shërbimeve ndihmëse të OST, ERE me anë të e-mailt të datës 28.02.2022 i kërkoi shoqërisë informacion mbi kapacitetet rezervë të përdorura në çdo orë, shoqëruar me çmimet respektive si dhe kostot e ndara për secilën Rezerve: FCR, aFRR dhe mFRR për të vlerësuar mënyrën e përlllogaritjes së shpenzimeve dhe të ardhurave të realizuara nga shërbimet ndihmëse për vitin 2021. Deri më sot, OST sh.a. nuk ka përcjellë informacionin e kërkuar në ERE.

“Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike” kanë hyrë në fuqi prej muajit Prill të vitit 2021. Duke pasur parasysh pasigurinë e lartë të shoqërisë në parashikimin e realizimit të këtij zëri për muajt e mbetur të vitit 2021, vlerësojmë se parashikimet e kryera për këtë shpenzim për periudhën 2022-2024 duhet të merren në konsideratë me rezervë.

Sa më sipër, realizimi i zerit “Blerja e shërbimeve ndihmëse” për vitin 2021 është vlere me përfaqësuese, e cila shërben si referencë për parashikimin e këtij shpenzimi në periudhën 2022-2024. Meqënëse “Rregullat e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike”, kanë hyrë në fuqi me datë 1.04.2021, vlerësojmë si të arsyeshme se për parashikimin e këtij grup shpenzimi për 2022 të aplikohet një rritje prej 10 % mbi kostot faktike të 2021. Në lidhje me parashikimin për vitet 2023 dhe 2024 vlerësojmë aplikimin e normës 5% mbi parashikimin e vitit paraardhës duke marrë në konsideratë lidhjen e centraleve të reja prodhuese në rrjetin e transmetimit.

Në përfundim, meqënëse përlllogaritja e këtij shpenzimi po bëhet ex ante, ERE bazuar në praktikën e ndjekur gjatë periudhave të mëparshme, do të njoh vlerën e këtij shpenzimi sipas të dhënave faktike për vitin 2022. Më tej, do të rivlerësojë dhe kompensojë diferencat rezultuese mbështetur në parashikimet e Ligjit 43/2015, i ndryshuar, si dhe Metodologjisë së përcaktimit të tarifave dhe çmimeve të sektorit të energjisë elektrike.

Pagesat ITC

OST sh.a, parashikon se për periudhën 2022-2024 do të shpenzojë 250 milion leke për pagesat ITC. Shoqëria deklaron se, kjo shumë varet nga marrëdhëniet e shkëmbimit të energjisë me shtetet e tjera dhe mekanizmi tek i cili bazohet llogaritja e ITC, më konkretisht PAN-EUROPIAN INTER-TSO COMPENSATION MECHANISM, i cili është projektuar për të kompensuar palët për shpenzimet që lidhen me humbjet e rezultuara nga bartja e flukseve të energjisë në sistemet e tyre. Për llogaritjen e një shpenzimi të tillë OST sh.a. është mbështetur edhe në trendin disa vjeçar të këtyre llojeve pagesave si dhe duke marrë në konsideratë faktin se

energjinë për mbulimin e humbjeve do ta prokurojë në treg të parregulluar. Rritja e çmimit të prokurimit të humbjeve do të influencojë direkt në rritjen e pagesave për CBT (Cross Border Transaction). OST sh.a. ka detyrimin të paraqesë në ERE raportim javor lidhur me zbatimin e Rregullave të TShB, në zbatim të pikës 6 të Vendimit të ERE nr. 255, datë 21.12.2021 ku përcaktohet se: “Përgjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike sipas VKM nr. 584, datë 22.10.2021, OST sh.a. të raportojë çdo javë në ERE mbi ecurinë e Tregut të balancimit të energjisë elektrike, duke filluar nga data e publikimit në Fletoren Zyrtare”.

Për arsyet e sipërcituara, OST sh.a. ka dërguar në ERE me e-mailin e datës 07.02.2022 Raportim javor për periudhën 01 deri 31 Janar mbi ecurinë e Tregut Shqiptar të Balancimit të Energjisë Elektrike. Në këtë raport konstatohet se vlera në Euro për t’u paguar nga OST sh.a. për vitin 2021 është 1,914,682.69 Euro. Në bazë të kursit të këmbimit mesatar vjetor të vitit 2021, vlera në lek rezulton rreth 234 milion lekë. Kjo vlerë është pranuar në përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara të realizuara për vitin 2021, ndërsa për vitet 2022-2024 janë konsiderur vlerësimet e shoqërisë sikurse paraqitet në tabelën e mësipërme.

Sherbime administrative te tjera

OST sh.a me shkresën nr.6901/3, datë 23.12.2021 parashikon një kosto mesatare vjetore për periudhën 2022-2024 për zërin Sherbime Administrative e të tjera prej 720 milion lekë. Nga analiza e zërave të specifikuar në aplikim vihet re se shoqëria në këtë grup shpenzimi ndër të tjera përfshin dhe mirëmbajtje, pagesa për organizma rajonale, të tjera etj. Në shkresën sipërcituar OST sh.a. ka parshikuar një vlerë për realizimin e këtij zeri për vitin 2022 prej 733 milion lekë me një rritje prej 24 % nga vlera e pranuar e këtij shpenzimi për vitin 2021 (duke mos konsideruar penalitetet prej 193 milion lekë), rritje e cila nuk është argumentuar nga shoqëria.

Nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2020 kosto faktike e këtij zëri është 495 milion lekë, ku në të janë përfshirë dhe shpenzimet e mirëmbajtjes, të cilat ne përlllogaritjen e të ardhurave të lejuara shoqërisë i parashikohen t’i njihen si zë më vete. Gjithashtu duke konsideruar pasigurinë që vetë shoqëria ka në parashikimin e realizimit të këtij zëri për periudhën 2022-2024 si dhe faktin se gjatë korrespondencave shoqëria nuk jep argumenta të detajur mbi ndryshimet e parashikimit të këtij grup shpenzimi, është vlerësuar që për periudhën 2022-2024 të konsiderohen kostot sipas të dhënave operative për vitin 2021, e më tej për çdo vit indeksohet me normën e synuar të inflacionit sipas vlerave të paraqitura në tabelën e mësipërme.

Pagesat për organizmat rajonalë europian dhe shpenzimeve të tjera për periudhën rregullatore 2022-2024, janë konsidruar sipas vlerave të realizuara nga OST sh.a. referuar pasqyrave operative të vitit 2021.

Mirembajtje dhe riparime

Ne aplikimin e shoqërisë nuk është parashikuar një zë i veçantë për Shpenzimet e Mirëmbajtjes dhe janë përfshirë në shpenzimet administrative e të tjera. Nga analiza e pasqyrave financiare të vitit 2020, ky zë është realizuar në vlerën 129 milion lekë. Në vlerësimin tonë për vitin 2021 është konsideruar realizimi i këtij zëri për vitin 2020 duke e indeksuar me normën e inflacionit të synuar prej 3%. Gjithashtu dhe për periudhën 2022-2024 është marrë në konsideratë parashikimi i çdo viti paraardhës duke e indeksuar me normën e inflacionit sikurse aplikuar për zërat e tjerë të shpenzimeve si më lartë.

Blerja e humbjeve

Për periudhën 2022-2024 në lidhje me shpenzimet për blerjen e humbjeve OST sh.a. parashikon:

- 3,741 milion lekë për vitin 2022, për sasinë 205 GWh
- 2,705 milion lekë për vitin 2023, për sasinë 210 GWh
- 2,257 milion lekë për vitin 2024, për sasinë 215 GWh

Lidhur me parashikimin e mesipërm, OST sh.a argumenton se me trendin në rritje të çmimeve të gazit, qymyrit, kuotave të CO₂ dhe energjisë nga burimet e rinovueshme, shoqëria pret një rritje të çmimit të energjisë elektrike deri në 2030.

Theksojmë se prej muajit shtator të vitit 2021, tregu i energjisë elektrike ka njohur një rritje të pazakontë dhe të menjëherëshme të çmimeve, si rezultat i së cilës shoqëria OST sha është impaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë për shkak të blerjeve të sasisë së energjisë për mbulimin e humbjeve në rrjetin e transmetimit. Vëmë në dukje se kosto e blerjes së humbjeve është një nga komponentët të cilët afekton ndjeshëm të ardhurat e kërkuara.

Për vitin 2022, i cili pritet të jetë edhe viti me impaktin më të madh sa i takon kostove të këtij zëri, vlerësojmë se shpenzimet për mbulimin e humbjeve të pranohen sipas vlerës së paraqitur nga OST në të ardhurat e kërkuara, me qëllim vijimësinë e ushtrimit të aktiviteti të shoqërisë. Në lidhje me periudhën 2023-2024, OST sh.a parashikon që çmimi i prokurimit të humbjeve në tregun e lirë për vitin 2023 të jetë në vlerën 105 Eur/MWh dhe për vitin 2024 në vlerën 86 Eur/MWh.

Duke qene se tregu i energjisë vijon të jetë tepër dinamik, si vlerësimet e shoqërisë, ashtu edhe vlerësimet tona janë mbështetur në parashikime mbi të dhëna apo informacione, të cilat ndryshojnë në varësi të ecurisë së tregut. Gjithashtu edhe për periudhën 2023-2024 janë pranuar parashikimet e shoqërisë në aplikimin e përditësuar, meqënëse dhe sipas publikimeve të ACER, parashikohet se çmimi i blerjes së energjisë në tregjet ndërkombëtare pritet të pësojnë një ulje graduale prej 25%-30% nga viti në vit.

https://documents.acer.europa.eu/en/The_agency/Organisation/Documents/Energy%20Prices_Final.pdf (link i dokumentit të lartpërmendur),

Kostot që lidhen me funksionimin e Operatorit të Tregut

ERE me anë të shkresës Nr.914/2 Prot, datë 11.10.2021, i kërkoi OST sh.a. paraqitjen e llogarive të ndara për të ardhurat dhe shpenzimet e realizuara në formë analitike të Operatorit të Tregut si dhe të Shoqërisë Bursa Shqiptare e Energjisë Elektrike - ALPEX sh.a. Ky dokumentacion duhet të pasqyrojë shpenzimet e realizuara të këtij aktiviteti për periudhën Janar - Shtator 2021, parashikimet e muajve të mbetur Tetor - Dhjetor 2021, të vitit 2022 si dhe të periudhës rregullatore të propozuar 2022-2024.

Me anë të shkresës Nr.5215/3 Prot, datë 04.11.2021, Shoqëria OST sh.a. dërgoi disa të dhëna tabelare, në të cilat evidentoheshin disa tregues indikativë që lidhen me aktivitetin e OT në tregun e energjisë elektrike si dhe deklaroi që Shpenzimet e ALPEX sh.a., nuk janë përfshirë në zërat e shpenzimeve të përlllogaritura në aplikimin për tarifën e transmetimit, ndërkohë që Operatori i Tregut është pjesë e strukturës së OST sh.a. dhe në përputhje me detyrat e parashikuara në legjislacionin në fuqi.

Kostot operative të realizuara dhe parashikuara nga OST lidhur me OT paraqiten në tabelën në vijim:

	Njësia	2020	9 Mujori 2021 Fakt	3 Mujori IV 2021 Plan	Viti 2021 i pritsmë	2022	2023	2024
Shpenzime Personeli	Mln ALL	20.94	8.4	3	11.4	29.00	29.58	30.17
Sherbime administrative e te tjera	""	8.95	4.6	1.53	6.1	7.55	7.33	7.37
TOTALI i Kostove Operative	Mln ALL	29.89	12.0	4.53	17.53	36.55	36.91	37.54

OST në vijim shprehet se: Metodologjia ekzistuese nuk është e bazuar në ndarjen e kostove sipas shërbimeve dhe në këtë mënyrë nuk ka të parashikuar të ardhurat e kërkuara për secilin shërbim të transmetimit. Këto kosto janë trajtuar të përfshira në kostot e OST sh.a sikurse është trajtuar në perlllogaritjet e mëparshme.

Nëpërmjet shkresës së sipërcituar, shoqëria ndër të tjera ka rekomanduar rishikimin e metodologjisë ekzistuese me qëllim ndarjen e kostove të OT por dhe përlllogaritjen e tarifave sipas përdoruesve të rrjetit të transmetimit si dhe kostove të shërbimeve të transmetimit duke vënë në fokus alokimin e të ardhurave e kërkuara sipas tipit të përdoruesve dhe shfrytëzimit respektiv të rrjetit të transmetimit.

Lidhur me këtë çështje, vlerësojmë se rishikimi i metodologjisë ekzistuese duhet të përcillet si një aplikim më vete në ERE në zbatim të përcaktimeve të nenit 26, të „Rregullores së Organizimit, Funksionimit dhe Procedurave të ERE-s“, duke propozuar ndryshimet konkrete në çdo pikë apo nen të Metodologjisë në fuqi.

Theksojmë se rishikimi i Metodologjisë ekzistuese nuk mund të realizohet në të njëjtën kohë me procesin e shqyrtimit të aplikimit të tarifës së transmetimit për periudhën rregullatore 2022-2024 për arsye të rëndësishme që kanë këto dy këto procese në raport me konsultimin publik, transparencën ndaj palëve të interesit si dhe impaktit që kanë rregullat dhe parimet e vendosjes së tarifave në përlllogaritjen e tarifës së transmetimit, e cila aplikohet ndaj përdoruesve të rrjetit.

Sqarojmë se ERE do të mund të vlerësojë rishikimin e Metodologjisë ekzistuese vetëm pas përfundimit të procesit të shqyrtimit të aplikimit të tarifës së transmetimit dhe pasi OST të ketë paraqitur kërkesën për rishikimin e kësaj metodologjie, e cila duhet të jetë e mbështetur në përcaktimet e legjislacionit të sipërcituar.

CAPEX

RAB (Baza e Rregulluar e Aseteve)

Me anë të shkresës Nr.914/4 Prot, date 26.11.2021, ERE kërkoi dërgimin në formate tabelare të listave të asetëve sipas kostos historike duke evidentuar shtesat përkatëse për çdo grup aset mbështetur në planet e investimeve të miratuara nga ERE, pasi konstatoi se baza e rregulluar e asetëve e shoqërisë OST sh.a. në aplikimin për tarifën e transmetimit është paraqitur e rivlerësuar. Gjithashtu është kërkuar dhe dërgimi i vlerave të amortizimit përkatës për periudhën 2015 -2020, pritshmërinë për vitin 2021 si dhe periudhën rregullatore 2022-2024. OST sh.a. me anë të shkresës Nr. 6954 Prot, datë 02.12.2022 ndër të tjera përcolli në formatin Excel tabelat dhe listën e asetëve sipas kostos historike si dhe vlerat e amortizimit përkatës, të cilat paraqiten si më poshtë vijon:

Viti 2015						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	120,700,353	11,020,444	36,725,782	83,974,571
2	Toka	211	1,262,944,777	5,433,010	24,085,986	1,238,858,791
3	Ndertesa	212	1,795,221,872	69,289,157	375,614,894	1,419,606,978
4	Instalime, makineri dhe Pajisje te tjera	213	36,625,813,526	1,180,880,109	9,276,765,634	27,349,047,892
5	Mjete transporti	215	651,384,576	90,421,364	280,648,525	370,736,052
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	333,760,347	29,237,913	184,954,196	148,806,152
	Total		40,789,825,451	1,386,281,998	10,178,795,017	30,611,030,434

Viti 2016						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	360,866,922	42,140,112	76,344,804	284,522,118
2	Toka	211	1,334,503,698	8,378,758	32,464,744	1,310,016,488
3	Ndertesa	212	2,629,212,665	108,211,881	478,961,606	2,150,251,059
4	Instalime, makineri dhe Pajisje te tjera	213	44,262,469,346	1,719,983,677	10,963,845,430	33,298,623,916
5	Mjete transporti	215	664,749,824	73,622,070	354,080,618	310,669,206
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	819,627,293	116,591,508	230,912,712	588,714,582
	Total		50,071,429,748	2,068,928,006	12,136,609,912	37,942,797,369

Viti 2017						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi i akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	632,124,826	76,662,325	153,007,129	479,117,698
2	Toka	211	1,334,503,698	8,257,982	40,722,726	1,293,780,972
3	Ndertesa	212	2,700,600,240	108,184,989	587,146,594	2,113,453,646
4	Instalime, makineri dhe Pajisje te tjera	213	45,554,600,347	1,894,136,360	12,832,588,438	32,722,011,909
5	Mjete transporti	215	702,874,681	67,190,767	406,061,946	296,812,735
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	934,627,693	144,397,379	373,846,304	560,781,389
	Total		51,859,331,484	2,298,829,801	14,393,373,136	37,465,958,349

Viti 2018						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	959,792,568	110,842,498	263,849,627	695,942,941
2	Toka	211	1,546,624,598	8,728,920	49,451,645	1,497,172,953
3	Ndertesa	212	2,724,694,704	106,353,994	693,358,958	2,031,335,747
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	48,076,779,218	1,879,547,590	14,700,872,673	33,375,906,545
5	Mjete transporti	215	711,098,158	57,521,516	475,165,096	235,933,063
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	1,088,369,491	140,639,947	496,633,431	591,736,060
	Total		55,107,358,738	2,303,634,464	16,679,331,430	38,428,027,308

Viti 2019						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	983,975,569	122,324,875	386,174,503	597,801,066
2	Toka	211	1,546,624,598	18,014,682	67,466,327	1,479,158,271
3	Ndertesa	212	2,765,094,165	102,368,933	795,727,891	1,969,366,275
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	49,833,305,133	1,945,876,685	16,645,524,703	33,187,780,430
5	Mjete transporti	215	711,098,158	46,062,139	521,298,570	189,799,588
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	1,226,503,186	150,383,554	646,961,192	579,541,994
	Total		57,066,600,809	2,385,030,868	19,063,153,186	38,003,447,623

Viti 2020						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	1,034,002,684	106,203,974	492,671,839	541,330,845
2	Toka	211	1,561,210,358	17,113,948	84,580,275	1,476,630,083
3	Ndertesa	212	2,835,146,332	99,907,673	895,635,563	1,939,510,769
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	50,945,811,965	1,910,699,506	18,556,208,417	32,389,603,548
5	Mjete transporti	215	708,275,758	36,825,874	556,462,515	151,813,243
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	1,282,089,432	131,110,572	777,278,894	504,810,538
	Total		58,366,536,531	2,301,861,547	21,362,837,505	37,003,699,026

Parashikimi 2021

Viti 2021						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e asetëve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e asetëve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	1,034,002,684	106,203,974	598,875,814	435,126,871
2	Toka	211	1,561,210,358	17,113,948	101,694,223	1,459,516,135
3	Ndertesa	212	2,871,649,982	101,580,757	997,216,320	1,874,433,662
4	Instalime, makineri dhe Paisje te tjera	213	53,150,973,496	1,940,617,026	20,496,825,443	32,654,148,053
5	Mjete transporti	215	708,275,758	36,825,874	593,288,389	114,987,369
6	Mobileri, pajisje zyre,pajisje informatike	218	1,379,188,245	143,728,175	921,007,069	458,181,175
	Total		60,705,300,524	2,346,069,754	23,708,907,258	36,996,393,266

Parashikimi 2022-2024

Viti 2022						
Nr	Pershkrimi	Llogaria kontabile	Kosto historike e aseteve	Amortizimi vjetor	Amortizimi I akumuluar	Vlera neto e aseteve
	1	2	3	4	5	6=3-5
1	Software dhe licensa	205/208	1,182,002,684	111,753,974	710,629,788	471,372,896
2	Toka	211	1,561,210,358	17,113,948	118,808,171	1,442,402,188
